



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal i 7/2026 i Kuvendit të Komunës

I Mbajtur në takimin e VI-rë të rregullt të KK-së me datën 30.06.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kryetarë i Komunës Agim Aliu, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për miratimin e kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029
5. Propozim – Vendim për Miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
6. Pyetje dhe kërkesa dhe
7. Të ndryshme.

Kryesuesi pasi e lexoi rendin e ditës dhe theksoi që në kpf jemi marrë vesh që të shtohet edhe një pikë e cila është propozim-vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me nr 76 i datës 21.07.2025 me anë të të cilit është aprovuar memorandumi i bashkëpunimit në mes komunës dhe ojc qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve shtëpia ime Ferizaj.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush rreth rendit të ditës.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit unë kam kërkesë që në rend të ditës në fakt të jenë dy pika për mu anulë që këtë kuvend që e keni qit në lajthitje për parcelën në rahovicë, kemi votu diqka tjetër ndërsa kjo ka shku në prishtinë, e tash sa i përket kësaj drejtoresha duhet me me dhan skjarime sepse ne komision kur jemi mbledh sdi pse jemi mbledhë ja tash ka ndryshu i kemi caktu edhe kriteret të cilat ai që ofertojn dmth e kan hjek emrin dhe na si komison mujm mi caktu kriteret e para ndërsa pika tjetër ka të bëjë me pronën në dremjak drejtoreshë besoj që i ke marrë ankesat edhe zyrtarisht propozoj që ajo pikë të anulohet për shkak ti kam dhan skjarimet në seancën e kalume dhe tash propozoj që të anulohen ato pika.

Kryesuesi theksoi që amir ti je anëtar i komisionit madje edhe kërkush nuk të ka vu në lajthitje, nuk është me rendesi vetëm qka propozohet po qka votohet, këtu është votu dhënjë në shfrytëzim e parcelës me numër kaq kaq kaq dhe është formu komisioni për vlerësim dhe për ankesa, qeky vendim është votu edhe ka shku për ministri dhe është kthy që është i ligjshëm, qetu është votu qeshtu.

Amir Rexhepi thekson që skem na nevojë mu mbledh si komision kur ti e ke caktu kujna ki mja dhanë pronën.

Kryesuesi thekson që komisioni është votu për këtë punë, kemi marrë vendim për dhanje në shfrytëzim, komisioni e vlerëson e bjen në kuvend edhe votohet, po të ishte në kundërshtim me ligjin naj kishin kthy që është kundërligjit, ti e ke qu mirë në prishtinë, Kryesuesi thekon që qashtu u votu, Amir Rexhepi mos i futni kë konflikt familjet në Dremjak.

Festina Sadiku pasi përshëndeti të pranishmit thekson që sa i përket pikës për dhënie në shfrytëzim paraprak në Rahovicë e kemi cekë edhe në seancën e kaluar që ka qenë një gabim teknik sa i përket propozimit, mirpo për dhënien në shfrytëzim të këtyre parcelave është formu edhe komisioni për

vlerësim ku pjesë e komisionit je edhe ti, edhe në komision amir e kemi diskutu kta, prej ministrisë na ka ardhë që është konfor ligjit, për atë arsye edhe jemi te shqyrtu dhe nuk është negociim direkt për këto arsye edhe është ba ankand publik, sa i përket dremjakut e kemi marrë ankesën jemi te shqyrtu dhe skemi marrë ende vendim.

Amir Rexhepi negociimi bëhet prej kryetarit, qka kem punë në komision kur jeni tja dhanë këti Arben Krasniqit.

Festina Sadiku thekson, Amir përderisa është ba formimi i komisionit pjesë e së cilit je edhe ti kjo do të thot që sëshët negociim direkt, po është me ankand publik edhe për këtë kemi diskutu edhe në komision.

Festina thekson që kam një pikë për trafostacion në nekodim, ku ka kërkesë për pjesën e ngastrës 371-0 për vendosjen e trafostacionit nga keds për dhënie në shfrytëzim afatgjatë.

Amir Rexhepi po skemi material derjtoreshë.

Festina Sadiku thekson që është tu sjellë materiali.

Kryesuesi thekson që mos flisni prej vendit kush dëshiron me marrë fjalën në foltore.

Festina Sadiku propozon që në rend të ditës të futet, plotësim ndryshimi i vendimit për dhënie në shfrytëzim për parcelat në rahovicë që të vendoset qmimi fillestar.

Brahim Osmani rreth rendit të ditës, pasi përshëndeti të pranishmit sështë hera e parë që na binë pikat sot për sot, edhe në mandatin e kalun kan dasht një anëtar i të kuvendit mja marrë shtëpinë pa e ditë, qysh me qu dorën, kryesus te lutna pak konsiderat se qytetart na kan zgjedh që dy mandate. Hajde ta ndryshojna meniher qka po ndryshojna, kejt tani mapl pi bjen jashtligjshëm pi mbani peng aty spi bini mi shfuqizu pasi është kuvendi me mas shumti shkelje ligjore.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit, Amir po ta përmendi emrin na si komision jemi mbledh kemi diskutu na prej mapl e kemi pranë te ligjshme edhe vendimi që kemi marrë kemi thanë që pe qesim kështu, smujna na me pru në pikën 0 kur e kemi të ligjshëm prej mapl, a ja japmi a sja japmi vendosim na, nëse si plotëson kushtet normal që na kem me vendos, mirpo sa i përket rrugës deri qetu e kemi vendimin e mapl-s, murrem edhe vendim at ditë në komision që në kuvend me qit edhe niher me caktu qmimin fillestar edhe jem në rregullt, ndërsa sa i përket keds-it, e kemi te let me shty mirpo e dini që me shty sot tani kedsi 6 muj jau shtyn kërkesën pse mi vanu, kërkesa u ardhe me vonese kjart po pse me shty që sa jam në asamble se di që kemi refuzu ksi pika najher, edhe tash naj bje shënimet e shikojm nëse ska pengesa pse me shty.

Amir Rexhepi masi ma permeni emrin replikë, drejtoresha pe pranon fajin psh te qmimi unë ju kom than se nenshkruj mnyra tash qysh po lypin plotësim ndrsyhim e ka kthy mapl-ja, tani e keni qu ndryshe.

Kryesusi thekson që se ka kthy asniher mapl këtë pikë.

Egzona Selmi pasi përshëndeti të pranishmit thekson që drejtoreshë ti përpos që je post politikë i thu vetes që je ingjinieri, duhesh me ditë rëndësinë e pronës publikë nuk është tash për tash me pru, duhet me dit ku është ajo parcele për qka është e destinume, të lutem të jeshë më e kujdesshme, qaq e pa rëndësishme është ajo parcele, kur e ka pru kur e ke shqyrtu me kanë e ke shqyrtu.

Kryesuesi pyeti nëse ka tjerë rreth rendit të ditës, fjalën e morri Arbër Bytyqi i cili thekson që po ngritën shumë qështje rreth rendit të ditës në nikadin duhet ta dini që ka të bëjë me dhanjë në shfrytëzim të një parcele për trafostacion na mujna me shty so problem po kështu shtyhet investimi dje i ka pru keds koordinatat, ne pjau krym një punë qytetarve pasi kërkesa është më e vjetër pasi për traf pa kalu në kuvend nuk ka mundësi, konsideroj që është për të mirë të qytetarve pasi na

mujm me shty sa dush po pju bajm një të mirë banorve të lagjesh berisha në nikadin dhe propozoj që të konsiderohet si e tillë edhe nga ju, investimi i gjith është i keds.

Fillimisht kryesuesi thekson që e njzerrë në votim rendin e ditës nga kpf dhe me 27 vota për 00 kalon rendi i ditës.

E kemi propozimin për plotësim ndryshimin e vendimit nr 76 i datës 31.07.2025, kush është për me 39 vota hyn në rend të ditës.

Festina Sadiku propozon që të futet në rend dite plotësim ndryshimi i vendimit nr 50 i datës 30.04.2026, futet në rend të ditës me 24 vota për 00.

Kush është që të jetë në rend të ditës edhe pika për nikadin, kjo pikë kalon me 24 vota për, 00.

Kryesuesi pyet kush është për rendin e ditës me të gjitha këto pika kalon me 27 vota për 00.

Kryesuesi thekson që sa i përket pjesëmarrjes skam informacion, rreth procesverbalit a ka vërejtje pasi spati u miratu procesverbali me 39 vota për 00.

Kryesuesi e lexon pikën e 4 dhe ia kalon fjalën kryetarit të komunës Agim Aliu.

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Nënkryetar i Komunës,

Drejtorë të drejtorive komunale,

Të respektuar anëtarë të Kuvendit,

Shoqëri civile, media,

Zonja dhe zotërinj!

Si në çdo qershor, për rrjedhojë të dëgjesave publike me qytetarët, bashkë vumë themelet e projeksionit buxhetor e vizionit të së nesërme për Ferizajn, përmes Kornizës Afatmesme Buxhetore – dokument ky që sot kemi në shqyrtim dhe përmes së cilës ngërthehen nismat e punët publike që e presin Ferizajn në vitet pasrendëse.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 është pasqyrimi i projekteve të Ferizajt për këto vite, janë pritjet e qytetarëve, është gjurma e tyre, që pavarësisht faktit të pamohueshëm e sfidues si asnjëherë më parë të shtrëngesave buxhetore nga çdo pore e trupit buxhetor të Ferizajt, megjithatë, ngre shtatin vizioni zhvillimor, puna e pandalshme, bindja e përkushtimi ynë për ta bërë Ferizajn e Gjeneratës së Re – për ta mbajtur lartë e referencë modelin e punës që ndërtuam për gjithë këto vite, me dashuri për qytetin, me sinqeritet për secilin qytetarë.

Sot, ky dokument do të marr edhe firmën e vulën tuaj, kuvendarë të zgjedhur të Ferizajt, për t'i thënë PO vazhdimësisë së punëve që shquajnë Ferizajn nga qendrat tjera, për të mos ndalur hapin pavarësisht pengesave, për atë që presin ferizajasit, për të cilën investuan besim, për t'i shpërblyer ne me punë e përkushtim për Ferizajn.

Dhjetëra projektet që përbëjnë këtë kornizë investimore, janë nistoret e zhvillimit të Ferizajt, duke fuqizuar akoma më shumë secilin segment që përbën mozaikun e plotë të një qyteti që njeh veç zhvillim, transformim e sinonim ka punën.

Duke çmuar secilin mendim të qytetarëve, propozimet që jetësojnë këtë dokument e reflektojnë qartësisht e tërësisht, nevojat që ferizajasit kanë për projekte zhvillimi, që jo vetëm sanojnë e tejkalojnë një gjendje, por i japin hove me ritme të pandalshme zhvillimit të gjithë Komunës sonë. Edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 pasqyrohet sheshazi kjo qasje transformuese, ky vizion zhvillimor.

Në planifikimin buxhetor të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029 për vitin 2027 në kategorinë e investimeve kapitale janë buxhetuar 15,400,000.00€ , në mallra e shërbime 12,183,659.00€, subvencione 2,550,000.00€ e pjesa tjetër e ndarë mes pagave dhe shpenzimeve komunale që përbëjnë tërësinë buxhetore prej 56,102,329.00€ për vitin 2027.

E ky planifikim buxhetor, përmban në vete një mori projektesh të fushave të ndryshme, që i japin fizionomi të re zhvillimi Ferizajt nisur me projektet e gjelbërta siç janë ato të masiveve të gjelbërta, projekti për zgjerimin dhe rregullimin e Parkut Liria ku ecuria e punëve po prek çdo ditë stade të reja zhvillimi, vepra që po shijohen çdo ditë nga qytetarët.

Po kështu edhe Parku në Kodrën e Sherretëve, një territor krejt i transformuar e rivitalizuar që po rritet e zhvillohet, duke njohur ecuria e këtij investimi – stade të reja zhvillimi.

Për të gjelbërtën janë dëshmitë e çdo ditshme ato që flasin zëshëm, për përpjekjen e përkushtimin që Ferizajt në gjithë trupin e tij t'i japim hapësirat që meriton, ambiente të mirëmbajtura, parqe të reja si Parku tek ish lokacioni i Kompanisë “Pastërtia” dhe në ish lokacionin e “Stacionit të Autobusëve”, të cilat do t'i tejkalojnë vështirësitë buxhetore për tu jetësuar së shpejti e që kthejnë qendrën e Ferizajt në një hartë të gjelbërt me të shumta zgjedhje për rekreacion e çlodhje për secilin ferizajas.

Në këtë mes vlen të përmenden edhe investimet që kryem në rivitalizimin e Parkut në Neredime e rregullimi i Parkut në Varosh, pa lënë anash edhe investimet që veçse kanë filluar për infrastrukturën turistike edhe në Jezerc, Pleshinë, Burrnik e zona të tjera në gjithë Ferizajin.

Sa i përket fushës së infrastrukturës, vijojmë me vepra publike që i japin kahe të reja zhvillimi Ferizajt.

Projekti për ndërtimin e Unazës së Brendshme të Qytetit, është vizioni ynë që do t'i mbetet dekadave që vijnë pas nesh, si një dëshmi sesi me guxim e vizion, shtati i qytetit ngritët e zhvillohet me ritmin e kërkesën e kohës.

Në këtë kuadër, planifikimet tona përfshijnë edhe investimin në rrugë qendrore të qytetit, përmes zgjerimit, rikonstruktimit si në rrugët “12 Qershori”, “Cen Dugolli”, “Bifurkacioni”, rruga që lidh kampusin e shkollave të mesme e rrugët në drejtim të zonave me potencial turistik të Ferizajt, si në Grykën e Neredimes, rruga “Naim Beka” punimet e së cilës veçse kanë avancuar e të tjera.

Në planin e infrastrukturës synojmë të mbyllim ciklin e investimeve bazë në infrastrukturën rrugore, duke përfunduar dhjetëra projekte asfaltimi, rregullime të trotuareve në fshatra, në qytet, investime në infrastrukturën nëntokësore si kanalizim e ujësjellës, për t'i hapur një kaptinë të re zhvillimi këtyre investimeve, në mirëmbajtjen e zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Në pikëpamje të shtimit të kapaciteteve në menaxhimin e ujërave të zeza si dhe për rritjen e furnizimit me ujin e pijes do të investojmë në ndërtimin e rezervarit të ujit në Nikadin, kolektorët në fshatrat Pojatë e Fshat i Vjetër.

Në pikëpamje të investimeve në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, vazhdon puna në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, po kështu edhe në objektin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Koshare, për të shtrirë këtë investim në këtë fushë edhe përmes ndërtimit të Qendre të re të Mjekësisë Familjare në qytet, ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare nr.12 në qytet, rikonstruktimit e QMF-1 në Qendrën Emergjente dhe Specialistike, pa u kufizuar edhe në furnizime me pajisje e aparatura me synim rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore si blerja e 3 veturave frigoriferë për nevojat e kujdesit paliativ, blerja e 10 oksigjen koncentrator etj.

Në planin arsimor, do të vijoj puna jonë për ndërtimin e infrastrukturës shkollore, si rikonstruktimi i hapësirave të shkollave të mesme në formë kampusi – një organizim e menaxhim ky novativ në arsimin vendor, po kështu ndërtimi i objekteve të reja shkollore si ndërtimi i shkollës së mesme në

Ferizaj, objektet e reja shkollore në fshatra si në Manastirc, Varosh, Tërrn si dhe investimet në ndërtimin e anekseve shkollore.

Kësaj i shtojmë edhe planifikimin e investimit për herë të parë në vend, ku të gjitha shkollat e Ferizajt do të jenë të pajisura me tabela të mençura (Smart Board) e po kështu do të bëjmë edhe rregullimin, furnizimin dhe digjitalizimin e kabineteve profesionale shkollore si dhe bibliotekave shkollore.

Për të vegjlit, kemi planifikuar ndërtimin e një çerdhe të re në qytet, çerdhe të reja në fshatra si në Grykën e Neredimes, Pleshinë, Talinoc i Muhaxherëve, po kështu duke ri konstruktuar edhe objektet ekzistuese shkollore për t'i shndërruar në çerdhe si në Lloshkobare e Komogllavë.

Për sportin shkollor, Ferizaj do të zhvilloj projektin për ndërtimin e Kompleksit Sportiv Shkollor tek hapësirat e ish Stadiumit të Qytetit “Ismet Shabani”, duke i shtuar edhe sallat e sportit, shkollave si “Vezir Jashari”, “Afrim Abazi” e “Riza Matoshi”.

Po kështu, Ferizaj do të ketë edhe një Sallë Sportive të Re, model në gjithë vendin me kapacitete që projektojnë përmbushjen e kërkesave të komunitetit sportiv, për dekadat e ardhshme të qytetit.

Pasurisë e aseteve sportive të Ferizajt do t'i shtojmë edhe Stadiumin ndihmës të futbollit në Sazli, pa lënë anash edhe qindra projekte të infrastrukturës sportive në qytet e fshatra që i japin dimension të shtuar sportiv, qeverisjes e projekteve tona në shërbim të sportit.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Një segment i rëndësishëm i qeverisjes sonë është edhe bujqësia. Në këtë fushë, Ferizaj është lider i mbështetjes për bujqit e fermerët në gjithë vendin. Do të vazhdojmë me projektet ekzistuese dhe ato të reja në këtë fushë si: subvencionimi i bujqve dhe fermerëve për pajisje, makineri për veprimtarinë e tyre përmes skemave mbështetëse financiare, rregullimi i kanaleve ujitëse, hapja e kanaleve për kullimin e tokave bujqësore, rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr si dhe projektet e rëndësishme kapitale si: Ndërtimi i Tregut të Kafshëve në Dardani, ndërtimi i Qendrës së Panairëve

– Hipodromit në Papaz, ndërtimi i siloseve për ruajtjen e grurit në Pojatë e të tjera investime që i kanë dhënë dimension zhvillimi ndër vite kësaj lëmie.

Në planin e kulturës, rinisë dhe sporteve, përveç mbështetjes financiare për skenën e pavarur artistike, do të vazhdojmë me ndërtimin e kapaciteteve të reja sportive e kulturore, si ndërtimi i fushave të futbollit në Saraishtë dhe Dardani, renovimi i Palestrës së Sporteve “Bill Clinton”, ndërtimi i sallës së sporteve për zhvillimin e sportit shkollor në shkollën “Ganimete Tërbeshi”, ndërtimi i fushave sportive në qytet e fshatra, fushat sportive me tarafleks, tribunat në stadiumin “Tefik Çanga” në Tërrn, pa lënë anash edhe investimin në rikonstruktimin e Qendrës Rinore dhe Kinemasë, veprën memoriale– rregullimin e Memorialit të UÇK-së si dhe ndërtimin e veprave artistike skulpturale - ndërtimin e Obeliskut kushtuar Kuvendit të Ferizajt të vitit 1908, si kujtesë për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në sferën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, Ferizaj ka bërë hapa të shumtë progresi, duke u ranguar komunë kampione në mbështetje të bizneseve e veçanërisht bizneseve të udhëhequra nga gratë.

Në këtë sferë, Ferizajn e pret edhe projeksioni zhvillimor që paraqet vizionin për ekonominë lokale, ai i ndërtimit të infrastrukturës për zonat ekonomike në Babush, Mirash e Gurëz që i jep kahe të reja zhvillimi e hove progresi – ekonomisë së Ferizajt, duke i mundësuar bizneseve kushte operimi e mundësi zgjerimi.

Kemi nisur edhe investimet kapitale si ndërtimi i infrastrukturës në zonën turistike Neredime-Jezerc, ndërtimin e infrastrukturës tek Ujëvara në fshatin Pleshinë, ndërtimin e murit alpin në Jezerc – zonë kjo në projeksionet e punës sonë ku është edhe rregullimi i zonës turistike rreth Kalasë së Jezercit si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes për persona të verbër në Neredime-Jezerc.

Zonja dhe zotërinj!

Anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029, me projekte të shtrira në çdo sferë, është garanca e prosperimit e hapave të sigurt të Ferizajt, drejt së ardhmes.

Duke ju falënderuar për mbështetjen tuaj të vazhdueshëm që i keni dhënë vizionit tonë, për më të mirën për Ferizajn e ferizajasit, ju ftoj që ta pasuroni me propozimet tuaja këtë projeksion

buxhetor, me projektet e Ferizajt të së nesërme e po ashtu jam besimplotë se edhe ky dokument, që burim ka kërkesën e qytetarëve, do ta gjej mbështetjen tuaj, për Ferizajn siç e meriton, të zhvilluar e të pandalshëm.

Ju faleminderit!

Kryesuesi pasi falënderoj kryetarin për këtë elaborim të KAB, theksoi që e hap debatin dhe ia kalon fajlën Visar Azemit i cili pasi përshëndeti të pranishmit thekson.

Korniza Afatmesme Buxhetore është një prej dokumenteve më të rëndësishme që e miratojmë gjatë vitit. Si e tillë, ajo duhet të pasqyrojë qartë vizionin për drejtimin që dëshirojmë t'ia japim Ferizajt në tre vitet e ardhshme.

Për fat të keq, dokumenti që kemi përpara përmban shumë zotime, shumë ide dhe shumë premtime, por mungon renditja e qartë e prioriteteve. Kur gjithçka shpallet prioritet, në fund asgjë nuk mbetet prioritet.

Në këtë dokument përmenden dhjetëra projekte strategjike – nga stadiumi i ri, zonat ekonomike, Bulevardi i Rinisë, “Ferizaji i Ri”, parkingjet nëntokësore e deri te digjitalizimi i plotë i administratës komunale. Por qytetarët kanë nevojë të dinë qartë: cilat prej këtyre projekteve do të realizohen realisht gjatë periudhës 2027–2029 dhe cilat do të mbeten vetëm në letër.

Njëkohësisht, disa prej sfidave më të mëdha të qytetarëve nuk trajtohen fare. Njëra prej tyre është furnizimi me ujë të pijshëm. Ky ka qenë dhe vazhdon të jetë një prej shqetësimeve kryesore të banorëve të Ferizajt, megjithatë në këtë dokument nuk gjejmë asnjë projekt madhor që adreson këtë problem.

Po ashtu, dokumenti parashikon rritje optimiste të të hyrave vetanake. Do të ishte me rëndësi të sqarohej mbi çfarë analizash mbështeten këto projeksione dhe cili është plani konkret për realizimin e tyre.

Ne nuk duhet ta miratojmë këtë dokument vetëm për të përmbushur një obligim formal. Duhet të sigurohemi që çdo euro e planifikuar të ketë një objektiv të qartë, ndërsa çdo premtim të mbështetet në një plan financiar dhe operacional të realizueshëm.

Shpresoj që gjatë hartimit të buxhetit për vitet 2027–2029, kjo kornizë të reflektojë prioritete të qarta, afate të matshme dhe projekte që u përgjigjen nevojave reale të qytetarëve të Ferizajt.

Brahim Osmani

Të dashur qytetarë, Kjo që sot e kemi para vetes është Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029, me gezon fakti që është rritur buxheti nga grantinqeveritar mirpo planifikimin që e ka bo kryetari

pra kjo kornizë e cila do të duhej të reflektonte hallet dhe nevojat e qytetarëve që sot për sot i kanë, e të cilat shihet qartë që ti ose nuk i di, ose nuk të interesojnë.

Tek investimet kapitale pra

Tek drejtorja e administratës që ju po kërkoni që në të besojmë se me 50 mijë euro që i ke zotuar për 2027 do të fillosh ndërtimin e komunës së re bile edhe me parking nëntokësor. Pak, ama shumë pak logjikë duhet për të kuptuar që as nuk e nis e as nuk e përfundon të njëjtin deri në 2029.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike ke planifikuar 300 mijë euro për rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit për gati gjysmën e fshatrave më të mëdha të Ferizajt.

Pse nuk bëhesh i sigurt për t'iu treguar që edhe këto 300 mijë euro ose i merr përmbaruesi, ose i alokon diku tjetër për të paguar ndonjë borxh të mbetur, bile me kamatë, sepse ndoshta jemi komuna që paguan kamatat më të larta për shkak të vonësive.

Në këtë kornizë, paramendojeni, në dy drejtorë keni bërë kode për rregullim dhe rehabilitim të rrjetit të ujit në Greme. Kryetarit të Gremes tash i ka ardhur radha të ndërtojë shadërvanë, sepse rrjetin e ke përfunduar moti kohë sipas postimeve tuaja në Facebook.

Ke planifikuar 100 mijë euro për rregullimin e parkut në qytet, Kjo punë do të duhej të ishte kryer mandatin e kaluar, por të gjithë e kuptojnë që ti e lë për 2029 kur vjen rendi i zgjedhjeve lokale.

Tregu i Gjellbër, paramendojeni, është premtim i vitit 2017. Ti sot ende nuk e ke nisur. Edhe një herë po e cek.

Ku e ke, more kryetar, atë projektin me sllajde të tregut që thojsh se do të dukej si në Zvicër?

A e di në çfarë kushtesh shesin blegtorët dhe fermerët e Ferizajt në këtë treg? A bash hiq nuk të intereson shëndeti i qytetarëve të tu që blejnë produkte bujqësore në kushte të tmerrshme?

Te Drejtoria e Infrastrukturës, ndërtimin e nënkalimit për vetura dhe këmbësorë tek stacioni i policisë, më falni, por a unë nuk po muj me vrejt mirë apo ti vetëm ia ke prerë shiritin dhe ia ke ndezur fishekzjarrët? A ka mbetur ndonjë borxh apo je ndarë shumë i kënaqur e po ia jep kompanisë bakshish ato 1.5 milionë?

12 Qershorin e ke lodhur, kryetar. Para 6 muajsh e ke kryer, edhe tash prapë i ke planifikuar 900 mijë euro.

A u krye keq apo çka është puna?

Bujqësia

Tregu i kafshëve dhe strehimorja e qenve endacak më në fund pas 8 vitesh ka përfunduar, por ju prapë keni planifikuar që 150 mijë euro t'ia ndani.

Këtu ose është punë borxhi që ia keni kompanisë.

Kjo kornizë kinse ka të bëjë me zhvillim ekonomik, por për çudi Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik ia keni lënë vetëm 3 projekte dhe rreth 130 mijë euro. Bile ngarkoje me punë edhe diçka tjetër drejtorin, se s'ka çka bën gjithë vitin.

E njëjta gjendje është te parku i Sherrretve. Para 5 vjetësh e ke premtuar, edhe 4 të tjera të duhen për ta kryer prej sot. Çdo herë duke besuar që nuk të duhen më shumë se 8 vite për të kryer një park.

Te shëndetësia ke planifikuar ndërtimin e shtëpisë së pensionistëve.

Para disa ditësh më ndali një pensionist dhe më tha: “Na keni rrejt, s’po na e ndërtoni shtëpinë që 8 vite.”

Kur e përfundoi bisedën, munda t’i them që nuk ju kemi rrejt ne, Agim Aliu ka qenë ai.

Edhe kryetar, kur vjen puna te fushat sportive në Dardani, banorët po kërkojnë të ndalen investimet në fushën sportive, sepse thonë se moti e ka kryer kryetari fushën.

Te Drejtoria e Arsimit për rajonet si Gryka e Nerodimes, rajoni i Pleshines dhe Talinoc i Muhaxherëve ke planifikuar për 2027 që të nisësh tri çerdhe me 50 mijë euro. Me lastik apo shator ke telashe t'i nisësh të trijat, e lëre më që ti asnjë tullë nuk e hedh për këtë punë deri në 2029. Përfundimisht, unë nuk kam fytyrë të votoj këtë kornizë, sepse kur dal para pensionistëve skuqem për mashtrimet e tua që ua ke bërë kësaj kategorie.

A takon ndonjëherë prodhues të blegtorisë, që produktet e tyre i shesin në tregun e askujt, sepse ai vetëm treg i gjelbër nuk është? Prapë fushat sportive të futbollit të madh në Dardani dhe Sazli.

Zhvillimi Ekonomik:

T'i përmenda çerdhet.

Sot prindërit që i takon në këto zona, a të shkon ndërmend që ata që kanë dy fëmijë një rrogë u shkon vetëm për t'i dërguar në çerdhe, sepse ka shkuar 170 euro çmimi për një fëmijë, e ti shpejt do t'ua shtrejtoshe edhe çmimin e çerdheve publike. Ujësjiellësi Sojeve, Dardani, Zllatar.

Parkun ne Rahovice po e kerkojn banort sepse ke premtu zgjerim.

Xhevat Sallahu pasi përshëndeti të pranishmit shumë kolegë këtu që janë moti anëtar të kuvendit janë si fontan dëshirash pasi nuk realizohen edhe jo 4 vjet e ardhshme po edhe 8 vite ndoshta, unë po ju tregoj që në vitin 2019 ekemi pas në projekt tretuarin në fshatin dardani e kemi pas edhe ne kab edhe buxhet po sot e at ditë su ba asniher, kem raste tash ku janë qashtjet ma emergjente si tregun ne dardani tash edhe qerdhja u ndërtu aty është shumë emergjent duhet këtë vit mu realizu e kemi problemin e ujrave të zeza na vyn një impiant, pasi krejt ujrart prej urës atje derdhen në fshatin sllatinë, ku së bashku me komuën e vitis duhet me bashkëpunu edhe me qeverin ku do ti mbështes personalisht, fusha e futbollit si e tha kolega qashtu është prej vitit 2010 ju ka premtu dardanis, e kam një fushë të fshatit zllatar mu ka premtu kam ba kërkesa disa herë, te shëndetsia ku drejtori ka parapa një amf në rakaaj unë kam thanë që në zonat 5 km më ndërtu qkmf e jo amf ku një motër medicinale shkon 1 herë në javë ju falemnderit.

Besnik Salihu pasi përshëndeti të pranishmit thekson që kam pyetje për drejtoreshën e financave si sponzorizuese e këti dokumenti, psh ndërtimi i shkollës së re në fshatin varosh që është i ndarë në tre vite në vlerë prej 130.000 euro a keni ndonjë projekt që një shkollë mund të kushtoj kaq, pastaj ndërtimin e 3 qerdheve në nerodime, pleshinë dhe talinoc i muhazherve në vlerë totale prej 150.000 euro a mund ti ndërtojmë me këto mjete, dhe ndërtimi i qmf-s në koshare që është i ndam në 3 vite në vlerë 650 mij euro që është normale ndërsa një tjetër qmf në qytet ku psh në koshare 650 mij euro ndërsa në qytet është 150 mij euro këtu dëshiroj ti marrë disa skjarime?

Arian Imeri ,

Te nderuar Antare te Kuvendit

Para vetes kemi propozim vendimin per miratimin e e Kornizes Afatmesme te Bugjetit. Po besoj qe te gjitha e dijme rendesin e ketij dokumenti nuk paraqet vetem nje planifikim financiar por edhe nje vision konkret per drejtimin qe duam ti japim zhvillimit te komunes tone ne vitet e ardhshme.

Ne kuader te projekteve te parapara gati ne te gjitha sferat kemi investime qe prekin drejtperdrejt jeten e qytetareve tane: infrastructure moderne ku vetem te infrastruktura publike kemi rreth 70 projekte, rregullim te infrastruktures arsimore si duke rregulluar objektet arsimore dhe infrastrukturen per rreth, ashtu, edhe rregullimi i kabineteve profesionale si dhe pajisja e shkollave me tabela digjitale. Mbi 3 milion euro ne Bujqesi pra jashte subvencioneve me pajisje te ndryshme edhe mbi 3 milion euro investime infrastrukturore te cilat shkojne ne funksione te zhvillimit te ketij sektori. Mbi 3 milion euro kemi te planifikuara ne projekte qe lidhen me projekte te gjelberta. Pastaj investime ne drejtorin e shendetesise, kulture rini dhe sport dhe ne drejtorit tjera te gjitha keto investime synojne te rrisine cilesin e jetes, te modernizojne sherbimet publike dhe te sigurojne nje zhvillim te qendrueshem ekonomik per komunen tone.

Normal qe edhe ne perpilimin e ketij dokumenti reflektojn sfidat me te cilat perballat komuna jone. E ato jane financiare dhe jane te shkaktuara nga mos mbeshtetja financiare qe i vjen komunes tone nga niveli qendrore. Kemi me dhjetra miliona borgje te paguara te cilat ligjerisht nuk i kane taku komunes tone por eshte dashte te mbulohen nga niveli qendrore dhe llogaritne situaten kur te kishim propozu nje KAB duke perfshi edhe keto mjete, me siguri do te flisnim per nje nivel krejt tjetër bugjetor dhe rrjedhimisht edhe per nje nivel tjetër te projekteve por edhe dinamikes me te cilen ishin kryer ato projekte. Punet qe priten te kryhen mbrenda tri viteve do te mund te planifikoheshin mbrenda vitit pare dhe nga afer 50 milion euro planifikime do te flitnim per afer 100 milion euro planifikime tjera

Duhet ta kemi parasysh qe komuna jone ka potencial ekonomik me siguri nje bugjet shume ma te larte se ky qe ndahet nga niveli qendrore, mirpo ashtu jane te rregulluara te hyrat shtetore qe jane te ndara sferat ku mundet komuna me inkasu mjete dhe pjesen tjetër te potencialit financiar qe e gjenerojne qytetaret dhe kompanit e komunes tone e inkason niveli qendrore, mirpo me kushtetute e ka obligim secila qeverisje qe tatimet dhe taksat qe i merr nga qytetaret mi kthy me sherbime dhe investime ne dobi te qytetareve dhe nje gje e till fatkeqesishte nuk po ndodhe ne komune tone. Perkunder kontributit te madhe ne bugjetin shtetore ne po mbesim mbrapa shume komunave te vogela qe kontributi i tyre ne bugjet eshte shume me i vogel.

Para disa diteve qeveria edhe pse ne detyre kishte miratu financimin e kater projekteve ne kater komuna edhe pse kemi edhe ministrin e financave edhe ministrin e infrastruktures nga komuna jone dhe ministri i infrastruktures i promovonte ato investime prap nuk ishte komuna jone e perfshire, por, ishin komuna e Mitrovices, Obiliqit, Fushe Kosoves dhe Graqanices. Pra, komuna qe udhehiqen nga partia ne pushtet. Dhe Ferizaji vazhdon te ndeshkohet per shkak perzgjedhjes politike qe kane bere ne nivel local edhe ate nga njerzit e qytetit te vet.

Perkunder kesaj mosperkrahje ne vazhdojme me kry pune dhe projekte qe jane pergjegjesi e nivelit qendrore, sepse siq e dini sherbimet e kanalizimit dhe ujesjellsit I kane ngrit ne nivel qendrore, prap edhe ne kete KAB nese i shikoni projektet e kanalizimit dhe ujesjellsit kemi mbi 3 milion

euro investime te planifikuara pasi jane sherbime elementare dhe perkunder mos perkrahjes nga niveli qendroren ne duhet ti mbeshtesim qytetaret me keto investime bazike.

Ne shume projekte po permendet rasti ku jane te ndara vetem nga 50 mije euro, zakonishte ne keto projekte pritet qe me u realize me donator apo investime te jashtme. Por, donator mund te jet edhe ministria, pse ministria ban me investu ne komunat tjera por jo ne Ferizaj. A ka nje shpjegim per kete ceshtja apo a eshte edhe Ferizjai komune e Kosoves? Pse Pershembull nuk perkrahet asnje prej projekteve qe planifikohet mu ndertu me mbeshtetje prej donatoreve apo ministrit.

Prandaj ju ftoj te gjithëve qe te perkrahim kete propozim, nuk eshte nje document politik ne kuptimin e ngushte partiak, por eshte nje document themelor mbi te cilin ndertohet i gjithe planifikimi financiar dhe zhvillimor i komunes sone, njeherit eshte edhe baze per fazat ardhshme te hartimit dhe miratimit te bugjetit komunal.

Pra eshte nje dokument shume me rendesi per komunën dhe qytetaret e Ferizajt, prandaj kerkojme mbeshtetjen e te gjithëve.

Bashkim Haliti pas përshënëti të pranishmit thekson që kam qef me pas një shpjegim që për mu jan kondradiktore psh te shpenzimet kapitale thuhet që kryesisht kan mu realizu nga të hyrat vetanake ndërsa raporti i të hyrave vetanake në shpenzime është veq 56% tjetër një prioritet është digjitalizimi i administratës komunale ku realisht ndikon në rritjen e efqiencës po nuk ndikon në rritjen e të hyrave, ndërsa këtu kemi për vitin e ardhëm diku 50 mij euro nga shërbimet komunale, tjetër ndërimiit objektit të komunës në këtë kab parashihet që me nga 50 mij euro të ndërtohet objekti i komunës së re, kjo i bjen që mrena 3 vite veq kan me fillu punët po ma shumë kan me pengu se sa mu ndërtu, gjithashtu njejt edhe ndërtimi i sallës së sportit janë të parapamë nga 30 mij euro për 3 vite, ndërsa nëse bahet fjalë për sallë të sporteve model këto janë shuma minore që smujn me kry punë kurgja, ndërtimi i silosit për ruajtjen e grurit në fshatin pojatë, këtu kisha pas qef me marr skjarim këto silose grurin e kujt kanë me rujt a të atyre privat fermerve apo kemi parcela të komunës dhe qysh ka mu menagju, pasi mi ndërtu siloset aty duhet edhe menagjim a ka me pas pagesa prej tyre a ka mu grumbullu tani mu shit prej komune këtë se kam te kuart.

Ejup Delolli pasi përshëndeti të pranishmit thekson disa skjarime për qytetart se sa për kuvendar opozitar, ne kur kemi dalë në zgjedhje kemi garu duke supozu që kan më na mbështetë edhe qeveriame projekte të cilat janë kanë, psh impiatni i trajtimit të ujrave të zeza 46 milion euro, Hekuran Murati e ka largu, nënkalimi ka pas marveshje për atë punë ka pas memorandum me zëvendësministrin Dimal Basha e ka largu, po folim për tregun a e dini pse tregu është në këtë gjendje se në mandatin e kalum e keni lëshu seancën ldk dhe vv skeni dasht mi dhanë epilog aty nisja e qedheve u përmendën disa kode a e dini pse janë këto, niset me 50 mi euro nuk kryhet po jemi te nisë, plus këtu po shohë prej anëtarve të vv që po kërkojnë impiante për trajtim të ujrave të zeza edhe nëpër fshatra të veta, qysh ka mundësi qysh ka logjik ju veq i merrni 35 mi vota për kurgja sjeni.

Amir Rexhepi pasi përshënëti të pranishmit thekson që u fol shumë u disku shumë mirpo shumica janë bartje të projekteve nga kohet e kalume, shumica janë borgje do ti paraqes tani sjan projekte të reja pom bajn përshtpje një projekt që përmendi kryetari edhe nga natyra e fushës sime pasi jam historian e përmendi ndërtimin e obileskut të kuvendit të Ferizajt prej 2017 ekemi qështu

veq bartet edhe nëse kryetari e kish ni te rëndësishëm kete moti e kish ndërtu, ndërtimi i tribunave në stadiume tefik qanga në tërn ka pas mu nis në mandatin e kalum një klub i fshatit që ka paraqit suksese e tash garon në ligë të parë, pyetje për drejtorin e shërbimeve publike shtrurja e rrugve dhe hapja e rrugëve të reja, është mirë drejtor me dit cilat janë ato rrug që kan mu hapë, se niset e përfundon kontrata e nuk përfundon asnjë rrugë, rrjeti i kanalizimit ujsjellist në Ferizaj, ku ki me instalu këtë rrjet o mirë me ditë lagjen me dit qka jem tu votu apo edeh kjo është obligim me pagu pastaj, ndërtimi i pritoreve në Ferizaj e paska cek epopeja e jezercit, a kan me kan pritore për trafikun urban që so tu funksionu apo veq si projekte, asfaltimi me 4 korsi cen dugolli deri te policia nja 3-4 her e kan qu dronin aty edhe rrugën e reqakut edhe këtu jan borgje, ndërtimi tretuarit kosin dremjak edhe këtu jan borgje, o let tash kur na paraqiten publikisht tha kontrata kolektive naj ka marre 17 milion euro që mi sfidu publikisht tregoni nr e stafit se si kan marre ata 17 milion euro e din kta pse përmbaruesi i ka marrë ato pare.

Asfaltimi kosin koshare ka përfundu kontrata as një rrugë su shtru aty për 3 vjet po sigurisht në lloshkobare ka naj borgj, zgjerimi rregullumi i parkut liria 1.3 milion qka do mi ba parkut kemi prioritet tjera qato psh me tabela digjitale duhet me pas prioritet arsimin tka dhez parku aty po frekuentohet po qka me ba aty ma edhe kodra sherretve a sktan dal paret aty a kemi borgje duhet mu skjaru, psh do projekte qe jan te përfundumu rikonstruimi i hapsirave ne form kampusi nëse o fjala për Shaban hashani ka përfundu në nerodime u kry aty keni ba foto, ish Shaban hashani gjon sereqi aneksi u ndërtu aty garant keni borgje ndonse ka përfundu, ndërtimi i qerdhes se re ne qytet edhe këtu e kam te pa kjart knej bjen propozime me dhan ne shfrytëzim knej ndan mjete per te re, nëse e ke nda menen mja dhan nje operatori spja permeni emrit skem nevoj me ndertu funksionalizoj qeto edhe ne rregull jemi.

Kryesuesi pasi konstatoj që ska tjer te interesuar për diskutim fjalën ja kalon drejtoreve.

Alberton Sahiti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që pe filloj prej brahës, ktu që e diskutove ndërtimin e kanalizimeve në këto fshatra, sësthtë ndërtimi i ri po është mirëmbajtja i kemi parapa edhe besoj që dalin këto, Amir sa i përket zhavorrit ne i marrim kërkesat e banorve, e kemi parapa mi rregullu, sa i përket trafikut apo pritoreve janë për urbano periferik, shpresoj që me i shti në buxhet edhe mi rregullu këto.

Burim Bajrami pasi përsheneti të pranishmit thekson që e ndjej të nevojshme te pergjigjem te pyetja për sillos për ruajtjen e grurit jemi në dijeni që kërkesë parësore është ruajtja e grurit përpos dhomave ftohëse që kemi investu kemi pa të rendesihme edhe ruajtjen e grurit si nevojte edhe strategjike ne nivel republike ruatjen e grurit pasi që edhe rezervat shtetërore ruhen nëpër objekte private, edhe ne kemi konisderu që Ferizaj meriton një hapsirë të tillë ku kapaciteti është 800 ton, po ta llogarisim edhe regjionin e Ferizajt së bashku me gilan shtime viti e regjion nuk kan mundësi mi mbush këto sillos me grurë, mirpo do tu japim hapsir fermerve që edhe së bashku me ojc apo organizimet e tyre ta funksionalizojmë pasi është e mundur që këta sillos të ndahen nga 2000 ton dhe te menaxhohen edhe nga ndërmarrjes publike ambienti nëse ndonjë forme tjetër sësthtë e mundur, edhe nëse smirren vesh fermerët kjo mund të shfrytëzohet edhe per rezerve shtetërore, kur dihet që qmimi i grurit është tepër i ulët, dëshirojmë që fermerët e Ferizajt ta deponojnë aty dhe te presin një qmim më të mirë për shitje.

Balton Dërguti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që këtu u ngritën dy qështje për drejtorinë e zhvillimit ekonomik, nga kryetari Visar Azemi u ngit qështja e zonave ekonomike është e vërtet që është kërkesë e bizneseve edhe vendore edhe të huaja problemi ka qenë që sjanë parapa nga pzhk, e më pas të eceet me procedurat tutje deri në fund të vitit besoj që do ta paraqesim pzhk në kuvend e mandej edhe ministria e tregtis e ka të parapam investimet për këto zona, Brahim Osmani drejtoria jonë nuk shquhet për investime kapitale mirpo për subvencione kryesisht, në drejtorit tjera skemi as staf që ti mbikqyrim projektet e mëdha kapitale dhe ato kryesisht janë të orientuara në drejtorinë e infrastrukturës psh, ju e dini që drejtoria e zhvillimit ekonomik në zonën e jezercit ka financu disa projekte në vlerë deri 1 milion euro mirpo jemi detyru që këto projekte të mbikqyren nga zyrtarët e drejtorisë së infrastrukturës për shkak që i përmenda me herët, Brah ne drejtoret bëjmë përpjekje për rritje të buxhetit qdo vit.

Arbër Bytyqi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që do të jap disa skjarime sa i përket tregut të gjelbërt mos të ishte qështja e borgjeve do të ishte qështje e kryer por pe shihni dhe vetëm se jemi në kërkim të donatorve njëjt do të ishte edhe kodra e sherretëve, sa i përket projektet me donator ne dardani zllatar, pasi këto qështje sjanë më qështje të komunës po banorët janë të ferizjat dhe mbi kete bazë po punojmë në këtë drejtim, ujrat e zeza në Ferizaj është anuluar si e përmendi Ejupi, përkundër problemeve financiare kemi marrë barrën e shpronësimit ndonse mund të arrij deri 10 milion euro, ndërtesa e komunës se ferizjat jemi te vetdishem që me 150 mij smund te përfundohet mirpo edhe këtu jemi në kërkim donatorve, ne spo kërkojmë si Gjilani 18 milion euro mirpo besojmë që 3-5 milion euro e përfundojme, sa i përket parkut në rahovicë hajde bahemi bashk brah që ta marrim pëlqimin prej agjencionit te pyejeve jemi te gatshëm e kemi kodin edhe fillojm investimin meniher, rruga 12 qershori veq se është rikonstruar tani me, diqka tjetër ska sa i përket drejtorisë së urbanizmit ju falemnderit.

Sebahate Ajeti Sadiku theksoi që sa i përket kab u përmenden disa qështje që i potencioi edhe kryetari e që sikur ta kishit degju aty janë në faqen 4 nëse ka nevojë e lexoj edhe njher u fol për rritjen e THV ku si dihet që e rritur kryesor është tatimi në pronë edhe gjobat në trafik, u tha këtu ndërtimi disa projekteve me vlera me te ulta dhe disa me te larta si e dini para se te filloj ndërtimi i tyre janë disa faza paraprake si hartimi i projekteve dhe ne bazë të mundësive buxhetore i kemi parapa përgaditjet fillestare, edhe qmf ne koshare është një projekt model që është duke u ndërtuar dhe për shkak te përmbarimeve është dasht që ta fusim përsëri për shkak të obligimeve ndaj operatorit.

Brahim Osmani është shumë interesant që pas qdo diskutimi përmendet Hekuran Murati tash edhe Dimal Basha po zgjedhjet kanë tregu sa ju dojnë qaq shumë ju kan deshtë keni mungese një deputet, unë rrugën bibaj deri autostrat, rruga pleshines krejt këto janë investime te qeveris po foli këtu 10% me 90%, po thot edhe dimal basha lan borgje, e keni një rrugë komunale psh Ferizaj-Rahovicë që le qe se keni ba po as se keni mirëmbajt krejt këto investime sjan sabotim, gjitha këto milione madje edhe qkmf e keni qu projektin ne fund tju ba presion ministria cilin projekt e ka ndal ministria përjashto memorandumet e kalume cilin veq nja gjama, tjetër per parkun në rahovice drejtor kur e keni fillu a keni pas leje ju skeni pas leje, ju masi i keni qit zhavorret i ka qit kryetari fotot që u kry apliko për leje e merr meniher amo jo me 3 shporta me i than park nacional, se sban ashtu, te 12 qershorit para Dimalit ti veq i paske pas qu paret posht, i ki qkmf naper Ferizajt jau ke

marrë operaturat e ti po thu pe ndërtoj jo more funksionalizoe pagujave rrogat me kosovamend
lani borgjet qe i keni bashkëfinancim.

Arian Imeri theksoi të gjitha projektet që po i përmend kanë qenë projekte të nënshkrua pse ndorn
qeverisa projektet mbesin e ki rastin edhe te rruga rahovices krejt ka qene e kryme madje edhe
kompania, unë pot sfidojë gjeje nje projekt përpos rrugës ne fshatin zllatar qe e keni fillu edhe
përfundu, pot sfidoj gjeje veq një që po i merrni qato vota qe i permende skeni ba kurgja e i keni
hargju 20 miliard euro qe pot sfidoj publikisht gjeje.

Xhevat Sallahu edhe njeher Arian so veq rruga ne zllatare eshte qerdhja ne dardani afër 1 milion
euro eshte rruga ramjan zllatar tash kemi hy per mirosal e lidh sllakofcion janë dikun 5-6 milion
ne atë zonë në shtator tash mujnë me hy punë aty.

Heset Maliqi pasi përshendeti të pranishmit thekson që kam shumë respekt për Sallahun tash mi
përmend për 5 vjet 5 milion euro e harrove me përmend spitalin, per bese duhni me dasht kosoven
me shume se me urrejt dike tjetër që ku te tha drejtori hajde bajme projekte, kam pernime shume
respekt per Sallahun i cili angazhohet qe me pru projekte per qytetin tonë, njëri po tregon këtu që
operatori ka të drejt me lyp dëmshpërblim se u nal projekti një dit pa u nënshkru e tash po kallzon
5 vjetë më vonë jemi te nisë rrugën e njëjta e ki rrugën fshat i vjetër, ae di qka janë tu hjek ata
njerz, edhe shumica se din që aj projekt o i qeverisë pse mos me dal me tregu për mua qeveria
është e jemja, kam qef me ardh pdk po edhe këtu u shëndrru kuvendi në lavdata për Dimalin në
vend qe mu mirr me projekte thu që është kod Dimali këtu, e përmendi Visari ujin e pishëm po
Visar të përkrahi qindpërqind në atë pikë po është edhe projekti i ujëmbledhssit që u blloku pse se
e ka nis dikush tjetër projektin e pi jet njakah lavdi ju falemnderit.

Ejup Delolli i nderuar kuvendar Sallahu unë e di që e qe ti e ke inicu atë qerdhe në dardani sa për
informacion të vetmin abstenim qe e kom ba u kan aj rast këtu në kuvend se unë nuk vi me abstenu
se unë budall sjam ja jam kundër ja për. A e di pse kam abstenu se na si egzekutiv bajshëm kërkesa
me aktivizu atë në greme se e demolun ju nuk naj shtojshi nr e stafit po me maru na objekte fizike
e mi lan për qenë endacak unë sjam idhtar me maru objekte për qenë endacak, kjo punë nuk bahet
me kan me ba edhe qaj stadion ku është a ka mundësi me ba naj foto.

Arbër Bytyqi unë e kam kritiku ministrin për arsye racionale pasi i kom prit qytetart në zyre ka
qenë uji, për shkak të rrezikut e fmive kurgja personale skam, krejt qka ju ka dasht ministrit për ni
kosto 2-3 mi euro edhe kish kalu uji pa problem, ndërsa sa i perekt 12 qershori ajo është riparuar
vitin e kalum dhe gjithqka shkon mire vitin e ardhshëm ajo rregullohet e as ju as na sbesoj që një
rugë në qendër te qytetit me lan ashtu.

Brahim Osmani qe bre ku ekeni prej fshatit te vjetër deri në autostrad ska planifikim për ndriqim
e komuna e ka menagju e ka tenderu, tjetër psh talinofc rahovic ka qene memorandum ato janë
ndal në krejt kosoven e mira o qe kem me perfundu besoj qe edhe komuna naj nimon, edhe per
spital u kan në prokuri bre paret jan kan te ndame, sa i përket slivoves drejtori u taku me kshilltart
e ministrin ti nëse e ke ba postimin pa u taku me meriotonin unë se di po o interesant po Dimali o
qe 3 muj e problemi o që 5 vite, amo ti o mire me bisedu me drejtorin e mi kry kto sene.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti te pranishmit e para sa i përket magjistrales ju e dini që ka pas me përfundu herët projekti ka qenë 12 milion euro, dhe arsytimi i qeveris ka qenë që pe ndalim gjakderdhjen financiare, dhe se di a e din që tash ka padi prej firmës italiane edhe pritët diku deri 5 milion euro dem tash ja keni dhanë salillarit me 19 milion euro plus qka dënohet dmth 100% u rrit kosto dhe është 5 vite vonesë, edhe tash del thu investim prej qeveris ky është investim prej berzhit e kush e ka marrë atë kredi atë e ka marrë qeveria Hoti.

Agim Aliu si e do zakoni në fund ta them edhe një fjalë, sa do që është riciklues unë bëra një ftesë që të jetë një zë pasurues, pat debat zhvendosës me tendencë përvetsimi mirpo këto projekte kan një kond kan një origjinë si kan than pleqt nëse është hanger pitja tepsia ka mbetë, ajo qka është fatkeqsi ato projekte janë vonuar dhe tash kan kosto tjetër pasi një projekt që ka kushtuar 10 milion sot smund të përfundohet as me 15 e 20 milion pa i futur edhe kosotot e penalitive, u tha ka po shkojnë parat unë po besoj që para dy muajve e kam paraqitur një shifër unë janë kryetar në vitin e 9 të vazhdismisë, 40.8 milion kam marrë obligime ndërsa deri para dy muajve kam thanë që kemi arritur deri 100 milion euro mirpo ajo qka unë jamë i lumtur është që në asnjë prej këtyre vlereave nuk ka firmën nënshkrimin e Agim Aliut, a ka më shumë se kaq gjakderdhje financiare kur mbi 94 milion euro kan përfutuar përmbaruesit.

Komuna e ka kaqikun e investimit në rrjetëzimin, deri sa të bëhet zgjidhja përfundimtare por ajo bëhet nga qeveria, u përmend granti po ashtu është në tendencë të përvetësimit, e që duhet ta rikthejn edhe grandit e 4 që është hjekur në vitin 2019, i cili ka qenë barazia që është shumë e proklamuar si retorikë ku në nr të banorve, edhe po të ndrrojnë vazhdushëm pushtetet do të garantonte barazi, e që është hjekur qëllimshëm, mirpo e dini që edhe përvoja e punës është rikthyer tek me vendimin e gjykatës kushtetuese, dhe mire që është futur pasi do të dilnim njëjt me vendimet e përmbaruesve, është zvoglu granti i arsimit psh e që se tha ktu askush, sa i përket qështjeve të projekteve i skjaruan drejtorët mirpo psh ristrukturimi i drejtorive dhe riemërtimi i drejtorisë për investimet kapitale pasi që ka pengesa dhe në këtë mënyrë do ti rregullonim këto, paradoksalisht në vitin 2019 ju ka dhën në babush një kompaie turke në tokë bujqësore, pzhk e 2017 ku ne skemi qenë në qeverisje u dasht me shfuqizu një marveshje pastaj për shkak që dokumentet e planifikimit duhet të jenë në sinkronë në mënyrë që të rregullohen këto qështje, u përmenden disa prej projekteve si nënkalmi besoj u kujtohet talljet memet shakatë me nënkalmimet ky i pari i vjetri si quhet tash pasi kemi ba edhe te rejat në propagandën e juaj ka pas shkuar deri 15 milion euro i cili në të vërtet ka kushtu 5.5 milion dhe jo bre spe mbulon uji ashtu si keni than ju, mos harroni janë edhe videoinqizimet por se kam përdorur si kandidat për kryetar njerzt që kane qenë sipër e kan futur thas me gurë në gypa të kanalizimit e kanididati i tyre ka qenë sipër aty mirpo se kemi përdorur kurr për politikë është rasti në polici, duhet ta dini që qdo projekt ka histori ka firmetar, qerdhja e re dua ta falnderoj publikisht zonjën hykmete Bajrami ajo te euro goma është nisur nga ajo dhe përfunduar në mes meje dhe z Ramë Lika, stadiumi shfletoni historin e buxhetit do e shihni kodin edhe në vitin 2017, mirpo kemi qenë në kontininetet me z Qeku, mirpo kemi dashur qe fillimisht te kemi një studim fizibiliteti pasi ka patur tendencë që të dërgohet në sazli, qka me folë për talinofc-rahovicë u tha këtu janë anulë që spaska pas mjete është një pyetje retorike se ka pas edhe në kuvend diskutim nga deputet tash ministra, pse kryetari ka nënshkru memorandum në jezerc në vlerë 50 mij euro po e vërtet me aq u nis po u përfundu me 6 milion euro.

U përmend obilisku qkas u tha këtu, unë kam nisur të qmoj këto vlera dhe këtë histori te begat dhe për dijeni te ati që shtroi dhe qytetarve unë si kryetar kam organizuar dy simpoziumë njëri në këtë sallë dhe tjetri në amfiteatrin në universitetin e Ferizajt.

U tha për kërkesat në qeveri, me dhjetra në komisionin parlamentar për buxhet por ato nuk mbështeten pyetni ata, ju e dini 16-18% Ferizaj kontribuon në buxhet, 2 her marveshja për trajtimin e ujrave e zeza është miratuar dhe të dy këto marveshje janë anuluar dhe tash pe shihni vonesat dhe kostot. Qysh e elaboroj edhe drejtori.

U fol për projektin e magjistrale Ferizaj Prishtinë, aty e keni një shpërfaqje shumë origjinale për atë që flet e që zotohet u tha gjakderdhja financiare por është interesante ri projektimi i ati projekti, aty është dashur ti ket 4 korsi njëkakshe dhe sot për tju përshtatur një biznesi është ristrukturuar, merdh keq këtu mthan mi nall parqet edhe kjo ndodhi një zë opozitar këtu tha mos investo në parqe nall parqet ndonse në fushatë thojshin spo investohet në parqe. Ne vërtet me inspektorit e qeveris në ditën e 1 majit pas orës 23 kemi pasur ndalesa për të punuar në parqe, por kjo nuk na ndal pasi e kemi pjesë të platformës këtë punë.

Duke e përdunduar ke një pyetje interesante qka ka ndihmuar komuna bizneset, dua ta potencoj që në këtë kuvend ka qene debati për tatimin në pronë dhe ka pasur kërkesa lëmoshe për lirim në 100 euro ne nuk pranuan se ishte e pa drejt ajo dhe kemi ulur normën tatimore për qytetin dhe qytetarët tonë në minimumin e lejuar për të gjithë përfshi bizneset e familjet e të gjithë e që ishte ulje 33% por do të shohim dorën e juaj për taksën progresive që do të hy në fuqi vitin tjetër. Kam edhe një pyetje pse qytetarët e Maqedonisë tash vijnë blejnë prona bëjnë biznes pasi ne kemi transformuar dhe kemi krijuar klime investive e frymë të punës falë mirëqeverisjes e mbështetjes sonë, ju falemnderit.

Kryesuesi thekson që pas fjalës së kryetarit debati përfundon dhe e qes në votim këtë pikë ku kaloi me 23 vota kundër 8 dhe 5 abstenim.

Kryesuesi e lexon pikën e 5 dhe ia kalon fjalën drejtorit Alberton Sahiti i cili thekson që ky plan ndërkomunal që është përfshirë në 12 komuna o plani ma i mirë në nivel republike i punuar nga ekspert të ndryshëm është financu nga dy banka europiane dhe u punu nga gizi gjerman shpresoj që kem me gjet mirëkuptim pasi si komunë Ferizaj Gjilan me përfundim mirpo do të kërkojmë donatorë.

Besnik Salihu- Të nderuar Kryesues, Kryetari i Komunës, kolegë asamblistë,

Po du me i diskutu disa pika lidhur me Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave! Kështu kur e sheh në letër tingëllon mirë, por kur e din që ndërmarrja që duhet ta zbatojë këtë plan është e kapur politikisht dhe e zhytur në keqmenaxhim, atëherë pyetja është se çfarë vlere ka ky plan?

Për këtë arsye, besoj se sot po humbim kohë duke votuar rregullore e plane që në praktikë nuk do të zbatohen, qysh nuk i keni zbatuar asnjëherë.

Nuk ka kuptim të miratojmë dokumente të reja, kur në KRM "Pastertia" nuk vendosin profesionalizmi dhe ligji, por interesat partiake e klanet e bizneseve.

Kuvendi e ka miratuar rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave ku qytetarët pranian të paguajnë më shumë me arsyetimin se do të përmirësohej shërbimi.

Sot, pas gjithë kësaj kohe, nuk e sheh asnjë rezultat? Të vetmet rezultate janë punësimet partiake?

Ndërkohë, ata që e mbajnë në këmbë ndërmarrjen – punëtorët fizikë dhe shoferët – punojnë çdo ditë në temperatura ekstreme, me paga të ulëta dhe në kushte të rënda. Kjo nuk është pasojë e mungesës së parave, por e keqmenaxhimit.

Tjetra, është turp dhe padrejtësi që punëtorëve, të cilët punojnë në kushte të vështira, u ndalen mjetet për Trustin nga paga, por ato asnjëherë nuk u transferohen në llogarinë e TRUSTIT. A bën me ditë, pse nuk po jau jepni paratë e Trustit?

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 28 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e për plotësim ndryshimin e memorandumit të bashkëpunimit e që është propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit me nr 76 i datës 31 07.2025 për memorandumin e bashkëpunimit në mes ojc qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve shtëpia ime dhe ferizjat.

Arbër Bytyqi thekson që për duhet te plotësohet vendimi paraprak më të drejtën e zgjerimit të objektit dhe e drejta e shfrytëzimit të oborrit, sa i përket ojc të gjithë e nihni kërkoj që ky memorandum të aprovohet.

Kjo pikë kaloi me 27 vota për 00.

Kryesuesi lexon pikën e 7 të rendit që është propozim vendim për plotësim ndryshim i vendimit me numër 50 i datës 30.04.2026 ku duhet të caktohet një qmim minimal për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të dhënies në shfrytëzim.

Sadat Ismajli propozon që qmimi fillestar të jetë 100 euro.

Arian Imeri tash u ngrit një qështje sa i përket kësaj pike nga Amiri është mirë me skjaru si kuvend propozim vendimi që u dërgu në ministri a e ka përfshi pjesën pasi e kemi mundësin kësaj here, ajo o shkelje që nëse ka ndodhë su dasht me shku pasi dmth mund te plotësohet tani.

Kryesuesi thekson që asgjë su shkuj asht kësaj veqse ka mungu qështja e vlerësimit financiar kurgja tjetër, tash është një propozim që të jetë 100 euro në vit, kush është që ti shtohet edhe vlere 100 euro vjetore, kush është për, kaloi me 20 vota për 00.

Vazhdojmë me pikën e fundit vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë kjo për zonën nekodim për trafo a dëshiron dikush të diskutoj.

Amir Rexhepi veq shpjegomani ku është qekjo, nekodim i thot kryesuesi, duhet me dit qka jeni tu votu, unë thash sjem tja pre thojt dikujt jemi ti dhan pronë, sjemi kundër po duhet me dit ku.

Drejtores merre një projektorë edhe paraqitna, ati kolegut Ismajl Sejdiut jemi kanë tja shpronsu shtëpinë.

Arbër Bytyqi propozon që të votohet ky vendim me koordinatat e sakta që mos të ketë probele në ministri.

Kryesusi e qet në votim me koordinata këtë pikë dhe kjo pikë kalon me 21 vota për 00.

Amir Rexhepi kam pyetje me drejtorin Alberton qka po nodhë me trafikun urban, pyetja tjetër të subvencionimi a ke ndërmarr diqka.

Për Afrim Llabjani 1. A kanë kontrata aktive të gjithë punojt e çerdhës publike në Greme?

2. Pse nuk po nënshkruhet kontrata me Caritas Kosoven, për angazhimin e stafit të edukatoreve, a edhe arsyeja sepse Komuna nuk mund të i zotëtoj mjetet financiare?

Dhe për Gazmend Bytyqi pse su hap thirrja për subvencionim të ojc?

Sadat Ismajli pyetje me polici kush bashkëpunon më shumë kemi rrezik sheshin me trotineta prej 18-23 me qenë një patrollë e policisë, Afrimi Llabjani qet kohën e pushimeve mi liru do objekte të shkollave mi parku gurbetqart veturat.

Egzona Selmi atëherë sot kam 3 kërkesa konkrete por para se me fillu kisha dashtë me reagu për reagimin e drejtorit Sahiti le të dallon fjalët pasi kërkesë më kërcënim dallon shumë ndërsa për kërcënimet dhe shpifjet ka kush mirret, dmth për drejtorin Sahiti kam pyetje kur ka mu hjek deponia në Greme për të cilën ke genj të manipuluar që sa, qështja tejte siguria nga qenët endacak që është përgjegjësi e juaja, a je të monitoruar qdo lagje ku janë kriju tufa të qeneve endacak që po e rrezikojnë jetën e qytetarëve, tjetra trafiku urban rruga vllëzrit gërvalla regjep bislimi e të gjitha ku o trafiku urban a veq për marketing politik i keni ba.

Brahim Osmani kam një kërkesë nga banorët e fshatit Mirash u premtu një rrugë ku e lidhë mirashin me softaj u premtu mendoj që komua tashmë ka buxhet për me zhavorr me shti në projekt atë rrugë pasi ka shumë nevojë atje, në fshatin Komogllavë në lagjen kurdie për shkak të problemeve politike kanë mbet disa rrugë edhe në fshatin Mirosalë të Xhaferi mu shtru me asfalt veq të ta ka mbet pa u shtru për qështje politike sipas banorëve atje.

Drjtori i kulturës thekson që për shkak të obligimeve financiare kemi vendosë që këtë vit vetëm të kryejm obligimet e vitin tjetër të ndajmë mjete për ojc.

Alberton Sahiti, trafiku urban në momentin që kryhet rruga do të funksionalizojmë, subvencionimi, do të jau përcjellim kurdo që ka mundësi komuna edhe retroaktiv do të jau pagujmë, sa i përket Sadatit është dita e 14 sot që policia po punon në atë drejtim.

Egzon e kemi diskutu edhe publikisht, pastërtia e ka fitu një grant për mi largu deponitë ilegale edhe ato janë në projekt mu kry, edhe do të kryjm, ju bëjë thirrje edhe juve që mos të ketë deponi mos mi vendos pastaj .

Burim Bajrami e kemi diskutu shumë shpesh qështjen e qenve endacak është shqetësim i madhë nëse niveli qendroë nuk përkushtohet në kemi me ba të pa mundur mirpo komunat përreth nëse nuk na ndihmojnë o problem unë seancën e kalime ka me prurë një raport për krejt punën e qenve endacak, është me kod penal e denushme që nëse nxiemi me ba ngordhje masive, kemi strehimoren mirpo ka kapacitet të vogël.

Arbër Bytyqi sa i përket rrugës Mirash-Softaj ajo jo veq me zhavorr po me asfall duhet mu shtru pasi e shkurton rrugën, unë kërkoj prej teje me ma kthy borgjin edhe me ma shti pak në projekt.

Kryesuesi e shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtesi:

Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kuvendit të Komunes

Xhavit Zariqi

